



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Ekonominë dhe Financat***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 16.2.2021, ora 09:30

**Drejton mbledhjen:**

**Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektligjin "Për vreshtarinë dhe verën" (*komisioni për dhënie mendimi*)

**Marrin pjesë:**

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Antoneta Dhima, Anila Denaj, Pranvera Resulaj, Shpresa Marnoj, Enslemvera Zake, Dashamir Shehi, Edmond Spaho, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Blerina Gjylameti, Ilir Topi, Etjen Xhafaj, Benet Beci, Bujar Leskaj

**Mungojnë:**

Erion Braçe, Vullnet Sinaj, Alban Xhelili, Alfred Rushaj, Jorida Tabaku, Agron Shehaj.

**Të ftuar:**

Dhimitër Kote – Zëvendësministër i Bujqësisë

Irfan Tarelli - Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural në Ministrinë së Bujqësisë

Alban Mësonjësi - Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Bujqësisë

Julinda Bare - Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Programeve të Bujqësisë në Ministrinë e Bujqësisë

## HAPET MBLEDHJA

**Eduard Shalsi** – Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë deputetë!

Sikurse ju kemi njoftuar, në mbledhjen e ditës së sotme do të diskutojmë një projektligj të rëndësishëm, i cili vjen si fryt i diskutimeve intensive prej kohësh.

Para se të fillojmë mbledhjen, të verifikojmë kuorumin.

Kuorumi është i plotësuar.

Mund të hyjë media.

Mbledhja deklarohet e hapur.

Do të fillojmë me prezantimin e projektligjit nga përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë.

Të ftuar nga Ministria e Bujqësisë janë: zoti Dhimitër Kote, zëvendësministër, zoti Irfan Tarelli, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, zoti Alban Mësonjësi, drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator dhe zonja Julinda Bare, përgjegjëse sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Programeve të Bujqësisë.

Ju uroj mirëseardhjen në komision!

A kemi prezent të ftuar nga Ministria e Financave? Nuk kemi.

Do t'ia jap fjalën zotit Kote për të na bërë një shpjegim konciz të ligjit.

Më pas do ta marrë fjalën relatorja.

**Dhimitër Kote** – I nderuar, zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Pas një konsultimi të gjatë në bashkëpunim me të gjitha dikasteret dhe ministrinë përkatëse, vumë re se ligji i vitit 1999 “Për vreshtarinë dhe verën” nuk i përshtatej trendit të rritjes së prodhimit, shtimit të sipërfaqes me vresht dhe prodhimit të verës në vendin tonë.

Si e tillë, për ta përqsaur këtë ligj me standardet e Bashkimit Europian, edhe në konsultim me grupet e interesit, për të rritur kontrollin e produktit, për të pasur një gjurmueshmëri dhe për të evidentuar me regjistër edhe kadastrën e të gjithë vreshtës, kemi sjellë sot para jush këtë projektligj për t'iu përgjigjur standardeve dhe nivelit të zhvillimit të këtij sektori shumë të rëndësishëm në Shqipëri.

Mendoj se në këtë projektligj janë përfshirë mendimet e të gjitha grupeve të interesit dhe është bërë një analizë e thelluar. Në Shqipëri sot kultivohen rreth 10 mijë hektarë vresht,

sipërfaqja më e madhe e të cilave është në Fier, në Berat, në Elbasan dhe më pas e shtrirë në të gjithë Shqipërinë.

E dyta, janë rreth 60 kantina që prodhojnë rreth 26 mijë hektolitër verë në të gjithë territorin. Trendi dhe interesi për këtë sektor është shumë i madh, por gjurmueshmëria, kontrolli, cilësia e produktit, etiketimi dhe të gjitha anët teknike të kryerjes së këtij procesi janë të parashikuara në projektligjin që ju keni përpara. Mendoj se me këtë ne do të hedhim një hap tjetër për t'iu afruar Bashkimit Europian, që edhe ky sektor shumë i rëndësishëm të ketë një ligj bashkëkohor për të ecur.

Tjetra, kjo do të sjellë rritjen e punësimit, cilësisë së produktit, të cilat ne i shikojmë në rritje, sepse në bujqësinë shqiptare sektori i agropërpunimit ka pësuar rritje në të ardhura, pasi kjo është vlerë e shtuar e produktit. Pra, nuk kemi vetëm shitje rrushi për tavolinë apo për tregje, por ky sektor e ka rritur zinxhirin për vlerën e këtyre produkteve.

Për sa u përket standardeve të kantinave tona, ne eksportojmë rreth 1 mijë ton sasi të verës. Raportet eksport-import janë në favor të importit, por duke u mbështetur në këtë ligj ne do të jemi më të kompletuar për të shkuar në nivelet e rajonit, por edhe Europës për sa i përket problemit të prodhimit të verës.

Dua t'ju vë në dijeni që sot Ministria e Bujqësisë ka të gjithë kadastrën e vreshtarisë në të gjithë territorin e Shqipërisë të digjitalizuar. Pra, është i vetmi sektor që ka digjitalizuar të gjithë sipërfaqen, vendndodhjen, vreshtin, vitin e parë, të gjitha vitet e prodhimit, shtrirjen dhe kultivimin në territorin e Shqipërisë.

Gjithashtu, ky sektor, përveç se i digjitalizuar, është edhe i regjistruar. Regjistri i fermës është në të gjithë territorin e Shqipërisë. Mendojmë se është një sektor model, që është më i kompletuari për sa u përket të dhënave statistikore, gjurmueshmërisë dhe llojeve të kultivarëve në territorin e Shqipërisë.

Megjithatë, jam i gatshëm për çdo pyetje tuajën.

Zoti kryetar i lexoi emrat e përfaqësuesve dhe ata e njohin sektorin. Jemi të gatshëm t'iu përgjigjemi të gjitha pyetjeve dhe ndërhyrjeve tuaja për problemet e projektligjit.

**Eduard Shalsi** – Faleminderit!

Zonja Resulaj.

**Pranvera Resulaj** – Faleminderit, kryetar!

I falënderoj përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë për prezantimin dhe prezencën e tyre!

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave është në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi dhe është i kuptueshëm edhe këndvështrimi në të cilin ne e fokusojmë këtë projektligj, pasi detajet dhe teknikalitetet janë objekt i komisionit përgjegjës.

Si Komisioni i Ekonomisë duhet të kuptojmë se është shumë e rëndësishme që ky ligj t'u vijë në ndihmë jo vetëm atyre që e prodhojnë, por të mbrojnë edhe konsumatorin. Kemi parasysh se flasim për një sektor që ka një ndikim shumë të madh në zhvillimin ekonomik. Kjo është pjesë shumë e rëndësishme e këtij komisioni dhe unë do t'i shtoja edhe një element tjetër, që ne na lind në të gjitha diskutimet dhe në jetën e përditshme, atë të turizmit, i cili është në zhvillim të vazhdueshëm në Shqipëri, dhe gjithmonë kemi kontaktuar se edhe vetë prodhuesit e verës, të cilët, për hir të së vërtetës, janë duke u shtuar, kanë një potencial shumë të madh. Ne kemi disa marka shumë të rëndësishme që e prodhojnë këtë produkt dhe duhet të ndihmohen për të pasur një konkurrencë të ndershme, për të pasur një treg të zhvilluar dhe, mbi të gjitha, për t'i dhënë produktit dhe markës shqiptare vlerën që duhet. Kjo ndoshta, e asociuar edhe me ligjin për pronësinë industriale, do të jetë një faktor ndikues dhe ndihmues.

Për ta kuptuar edhe publiku i gjerë, projektligji në terma të përgjithshme është një kuadër rregullator, ku shprehet edhe fjalja: "...për të gjurmuar çfarë ndodh nga vreshta deri në tavolinë", pra të gjitha elementet që ndikojnë në prodhimin, tregtimin, shpërndarjen, marketimin e këtij produkti dhe sigurisht, një kuadër rregullator është i domosdoshëm.

Sikundër i nderuari zëvendësministër e tha pak më parë, ligji ekzistues i vitit 1999 nuk i përmbush më pritshmëritë e prodhuesve, të konsumatorëve, të zhvillimit të tregjeve ndërkombëtare e të tjera. Kjo është primare të themi për atë që ofron ky projektligj, i cili synon të ketë një rregullator midis prodhuesve, ofruesve të vreshtave e të tjera, të ketë, si të thuash, një analizë të qartë dhe një pasqyrë, një panoramë të evidentuar.

Për të mos u zgjatur dhe për t'u lënë hapësirë kolegëve për të zhvilluar debatin nëpërmjet pyetjeve dhe diskutimeve, unë kam disa komente.

Në projektligj përmendet se ne do të kemi një regjistër të vreshtarisë. Kjo është shumë domethënëse dhe ndihmuese, por në të njëjtën kohë përmendet, sikurse edhe ju e thatë, kadastra e vreshtarisë. Ndoshta do të ishte me interes për ne për të kuptuar një lloj diference: terminologjia i referohet të njëjtës gjë apo ka ndonjë diferencë mes tyre, për sa kohë që përmenden në të njëjtën kohë termat "regjistër" dhe "kadastër"?

Gjithashtu, për sa i përket asaj çfarë thashë në krye të herës, besoj se interesi i prodhuesve dhe i grupeve të interesit është shumë i madh në këtë rast. Unë jam e sigurt që janë zhvilluar diskutime dhe debate, sepse i kemi hasur edhe ne në rolin e qytetarit të thjeshtë, aq më tepër ju si specialistë të kësaj fushe, dhe do të doja të dija cili ka qenë opinionin dhe

qëndrimi i grupeve të interesit për këtë projektligj? A kanë sjellë ata rekomandime, që ju t'i trajtoni më pas?

Për sa u përket kostove financiare që ndeshen, aty përmenden vlera 2 milionë e 300 mijë, që i referohet kryesisht shpenzimeve për komisionin e vlerësimit, inspektoratet e të tjera. Për mendimin tim, në projektligje të tilla, që kanë rëndësi shumë të madhe për përfitimet ekonomike që do të vijnë më tej, kostot nuk përbëjnë peshë shumë të madhe dhe një element shumë të rëndësishëm, por duhet qartësuar viti buxhetor që do të ngarkohet me këto shpenzime, për sa kohë thuhet se ligji do të hyjë në fuqi pas 2 vjetësh nga miratimi i tij. Ndoshta nga pikëpamja e teknikaliteteve fiskale duhet të përcaktohet më qartë se kujt i referohet dhe në cilën periudhë do të ngarkohet buxheti i shtetit me këto shpenzime.

Në përfundim, për vetë rëndësinë që ka sektori dhe projektligji që ju po prezantoni sot, do t'i ftoja të gjithë kolegët ta miratojmë atë dhe mbi të gjitha, ta vëmë në zbatim në mënyrë korrekte, në ndihmë të prodhuesve dhe të konsumatorëve në momentin kur ai të hyjë në fuqi.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Faleminderit, zonja Resulaj!

Para se t'ju jap fjalën për pyetje, kam diçka për të thënë.

Në dokumentin që kam për rezultatet e konsultimeve publike për projektligjin “Për vreshtarinë dhe verën”, referohen vetëm konsultimet e vitit 2020. Konsultimet elektronike përmes regjistrit elektronik 30.06-30.07.2020, takimet publike në mjediset e ministrisë, 05.10–11.11, komunikimi përmes postës elektronike 6 vjet. Pse ka kaluar një kohë kaq e gjatë nga periudha e konsultimit publik, që është viti 2020, ndërkohë që jemi në vitin 2022?

**Alban Mësonjesi** – I nderuar kryetar,

Projektligji ka në Kuvend prej një kohe të gjatë, që në legjislaturën e kaluar. Pra, është miratuar në Këshillin e Ministrave në dhjetor të vitit 2020, ka ardhur në Kuvend, por në legjislaturën e kaluar nuk u miratua dhe tani ka filluar shqyrtimi i tij.

E para, çfarë është shkruar për konsultimin publik, i përket periudhës para miratimit në Këshillin e Ministrave. Pasi projektligji ka ardhur në Kuvend, ne kemi vijuar komunikimet me ta, por nuk janë të pasqyruara në dokumentacion.

**Eduard Shalsi** – Dakord.

Ndërkohë, jeni në komunikim me Komisionin përgjegjës të Veprimtarive Prodhuese?

**Alban Mësonjesi** – Kemi komunikuar me Komisionin e Veprimtarive Prodhuese; kemi komunikuar edhe me aktorët që kanë nevojë për një rikonsultim publik në komision dhe

ata do të vijnë në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese me propozime konkrete. Pra, do të bëhet edhe një konsultim tjetër në komision.

**Eduard Shalsi** – E kuptova.

Zoti Spaho.

**Edmond Spaho** – Faleminderit!

Unë nuk kam ndonjë pyetje të veçantë për projektligjin, por përfitoj nga rasti, meqenëse kemi prezent ekspertë që merren prej shumë vitesh me çështjet bujqësore, ju bëj thirrje të kërkoni me insistim kthimin në regjimin e TVSH-së para vitit 2019, pasi po merrni më qafë bujqësinë dhe blegtorinë, duke i dhënë dorë importit të mallrave dhe rrënimit të prodhimit vendas. Ju bëj thirrje juve si specialistë dhe ekspertë të vjetër, sepse ministren e keni komplet *out*: nëse doni që ky aktivitet, që zë 20% të prodhimit të brendshëm, që jeton 40 e ca përqind e popullsisë, ju keni përgjegjësinë të ngriheni dhe ta kërkoni me forcë, pasi masat fiskale të marra nga viti 2019 e më tej po e rrënojnë bujqësinë dhe blegtorinë, duke favorizuar importin.

Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Eduard Shalsi** – Para se t’ju jap fjalën, kam edhe një pyetje për përfaqësuesit e ministrisë.

Kemi informacion se grupet e interesit dhe ekspertët kërkojnë të bëhen përmirësime në projektligj, a jeni në dijeni?

**Alban Mësonjesi** – Jemi në dijeni që ka kërkesa të tilla, por nuk janë të formalizuara te ne. Besoj se gjatë javës tjetër, kur të shkojmë në komision do të njihemi paraprakisht për propozimet konkrete.

**Eduard Shalsi** – Pra, deri tani nuk kanë ardhur te ju, sepse më thonë se propozimet kanë ardhur edhe në ministri.

**Alban Mësonjesi** – Ne jemi njoftuar nga Kuvendi, por një nga shoqatat na tha se do ta finalizojmë të martën, pra nuk kemi propozime konkrete nga ana e tyre. Gjatë shqyrtimit në komisionin përgjegjës ne do të jemi në dijeni për propozimet konkrete dhe jemi të hapur edhe për përmirësime nëse do të gjykohen.

**Eduard Shalsi** – Qartë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, kam merakun se mos ndodh si me ligjin tjetër, për të cilin po bëheshim gati ndryshimet, por u tërhoq. Pra, duhet të marrim një vendim që të dimë se si ta diskutojmë.

Po, zonja Dhima, pastaj e ka fjalën zoti Agalliu.

**Antoneta Dhima** – Falënderoj zëvendësministrin për prezantimin!

Unë kam dy pyetje:

Së pari, një pikë shumë e rëndësishme e këtij projektligji janë kundërvajtjet administrative, masat dhe ekzekutimi. Sanksionet për kundërvajtjet administrative vijnë nga 50 mijë lekë deri në 100 mijë lekë dhe disa sanksione të tjera. Unë dua të di nga ana juaj se cilat janë referencat për masat e gjobave që keni vendosur?

E dyta, nga ana e relatores u theksuan kostot financiare, e cila është pjesë e relacionit që shoqëron projektligjin, por cila ka qenë metodologjia që ju keni përdorur për të arritur në këtë kosto prej 2,3 milionë lekë?

**Eduard Shalsi** – Fjala për zotin Agalliu.

**Arbi Agalliu** – Në vijim të shqetësimit që ngriti zoti kryetar, te materiali që kemi marrë, që është vendimi i datës 24.12.2020, renditen një sërë subjektsh që paraqiten si grupe interesi, të cilat kanë bërë rreth 52 komente. Nga këto janë pranuar rreth 15 apo 20 prej tyre, ndërsa pjesa tjetër janë refuzuar. Tashmë situata ka ndryshuar, pra ka 2 vjet hapësirë. Ajo që me të drejtë ngriti zoti Shalsi duhet që të merret parasysh, sepse në këta 2 vjet ka ndryshuar situata ekonomike e vendit, ka ndryshuar raporti i produktit cilësi – çmim për një sërë faktorësh dhe në këtë kontekst unë e gjykoj të nevojshëm një komunikim në tavolinë mes jush si ministri dhe grupeve të interesit, të cilat i kanë komentet e bëra. Pra, është e nevojshme që të bëhet një përditësim i atyre komunikimeve, sepse në këta 2 vjet tregu është zhvilluar dhe problemet janë shfaqur. Prandaj duhet të marrim një përgjigje të saktë nëse është bërë si proces apo nuk është bërë. Unë mendoj që, përpara se të vijojë ky projektligj, në patjetër duhet të kemi një lloj konsulte me ata aktorë, grupe interesi që janë domethënës në tregun shqiptar. Ky është si shqetësim.

Ndërkohë, bashkohem edhe me atë që tha zoti Spaho, për pjesën e bujqësisë, si një nga sektorët më të rëndësishëm të këtij vendi. Ministria është politikëbërëse, por ju si specialist duhet të bëni amortizimin mes presionit të qeverisë dhe atë çfarë me të vërtetë ka nevojë tregu.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Po, zonja Denaj.

**Anila Denaj** – Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje!

Faleminderit për pjesëmarrjen!

Unë kam vetëm një pyetje që lidhet me komentin e zotit Agalliu. Sigurisht, unë jam pro konsultimeve publike, por në raport me këtë projektligj, i cili është një përafrim me një

direktivë dhe kur përcakton rregullat, dispozitat e përgjithshme se si ky sistem të jetë sa më afër atij europian, pyetja që lind është: çfarë përmirësimi do të kishte një konsultim i dytë publik nëse do të ndodhte tani, sepse rregullat janë të pandryshuara nga kushtet e këtij dyvjeçari? Duket sikur po zvarrisim një proces, që duhet të jetë sa më shpejt në zbatim për të gjithë operatorët.

Sigurisht, çështja e kostove është diçka që ju do të jepni vetë përgjigje për referencë, por mendoj se nuk duhet të futemi pafundësisht në diskutime, të cilat vonojnë një projektligj që përmirëson sistemin.

**Eduard Shalsi** – Po, zoti Agalliu.

**Arbi Agalliu** – Materiali mban datën 24 dhjetor 2020, pra do të thotë se konsultimet janë bërë para kësaj date. Po të jetë se do të mbajmë aksiomën që projektligjin e bëjmë sipas atyre që kërkohet nga Bashkimi Europian, atëherë harmonizimi i politikave apo standardeve të caktuara është e kotë të diskutojmë me grupet e interesit, pra i bie që të mos diskutonim me grupet e interesit edhe më përpara. Në këtë periudhë 2-vjeçare nuk e dimë se çfarë ka ndryshuar, sepse tregu ka ndryshuar dhe mund të ketë elemente që janë të domosdoshme për t'i implementuar, mund të ketë elemente që nuk kanë rëndësi, por edhe mund të mos kemi ndryshim fare. Në një periudhë 2-vjeçare patjetër që ndodhin ngjarje, sepse ka qenë situata e pandemisë, postërmeti, zgjedhjes e të tjera, dhe tregu nga të gjitha këto...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Përafrim është, atëherë përse duhet të konsultohemi për përafrimin edhe përpara se të...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për të njëjtën arsye që është konsultuar...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Çdo element që ky projektligj prek, në mendimin tim, duhet të konsultohet edhe njëherë me grupet e interesit, sepse një periudhë 2-vjeçare është gjysmë mandati qeverisës dhe nuk ka asgjë të keqe që me ato grupe interesi, me të cilat qeveria i ka linjat e komunikimit, ministria, sepse është në kontakt të përditshëm, të bëhet një *update*, një *follow up* të rekomandimeve që kanë pasur për të nxjerrë një projektligj sa më afër tyre, sepse po ndoqëm parimin që është përafrim, atëherë kot sa i pyesim.

**Eduard Shalsi** – Zoti Agalliu, e dëgjova opinionin tënd edhe të zonjës Denaj, por me ministrinë ne do të jemi në kontakt, sepse unë kam bindjen që ligji ka nevojë për ndryshime, sapo të konsolidojmë dhe ripropozimet, propozimet e modifikuara apo shqetësimet e ardhura



nga biznesi ne do t'i shohim nëse ka diçka që mund të vijë si përmirësim i ligjit. Konsultimet sa më të shumta të jenë, sa më intensive aq më frytdhënëse janë.

Gjithsesi, ne kemi edhe një rast të një ligji tjetër, i cili ishte konsultuar, zonja Denaj, para 2 vjetësh, ndërkohë u tërhoq nga Ministria e Bujqësisë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E kam fjalën...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ai ligj nuk ishte përafrim i nderuar, por ishte në parlamentin e Shqipërisë prej kohësh, ndërkohë që u tërhoq për t'u përmirësuar, apo jo? Po, pra.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, për sa kohë kemi një rast të tillë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E kam fjalën për ligjin e duhanit. Po, ku ndryshon në konsultime nga ky ligj, pra është e njëjta kauzë, këtë dua të them. Sidoqoftë, nëse do të ketë nevojë për ndërhyrje ne do t'i bëjmë ndërhyrjet.

Ia jap fjalën zëvendësministrit dhe përfaqësuesve të ministrisë së Bujqësisë nëse kanë diçka për të shtuar në komentet që bënë kolegët deputetë.

Të nderuar kolegë, të gjithë jemi dakord në parim se ky ligj ka nevojë për t'u miratuar dhe nen për nen do ta referojmë në një seancë tjetër, duke qenë në komunikim të vazhdueshëm me Komisionin e Veprimtarive Prodhuese. Pra, përveç konsultimeve që i bën ministria, ka plot shembuj se si në seancat parlamentare ligjet janë përmirësuar. Në këtë ligj kemi edhe Shërbimin Ligjor të Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, me të cilin do të harmonizojmë përpjekjet dhe punën mes dy komisioneve.

Fjala është për ju për të dhënë përgjigje, por edhe komente mbi atë çfarë u tha për bujqësinë.

**Dhimitër Kote** – Unë i dëgjova me vëmendje të gjitha mendimet e zotërinjve deputetë, kuptohet që nuk ka vlerë nëse nuk dëgjojmë grupet e interesit, sepse bujqësinë shqiptare e zhvillojnë ata, biznesi e zhvillon. Ne bëjmë politika me ligje, ndërsa për pjesën tjetër ata e kanë topin, pra ne nuk mund të bëjmë gjë pa ta. Ky është një diskutim që ne e kemi bërë gjerë e gjatë dhe është si puna e zdrukthit, që sa herë kalon aq më shumë probleme nxjerr. Prandaj, nuk ka diskutim që kjo gjë duhet të ndodhë, por ne duam që ky ligj të ketë jetëgjatësi, nuk duam të kemi një ligj të nxituar dhe të shpejtë për ta arritur sot, sepse bujqësinë tonë ne nuk do ta lëmë në dorë të rastësisë. Ne do të ndërrohem, sepse jemi me orë

pune si “kushinetat”, por problemi është se fermeri do të ngelet përsëri atje, ai që bën verën po ashtu dhe me atë ligj ne mund të krijojmë pengesa.

Nuk ka diskutim që ka dashamirësi dhe mirëkuptim të plotë për këtë gjë, edhe ju si deputetë këtë mision keni, pavarësisht bindjeve, por ne mendojmë që kjo gjë do të vazhdojë të përmirësohet, siç e thatë edhe ju.

Ndërsa për atë që thatë, se çfarë ka ndryshuar këta dy vjet, ka pasur ndryshime në vlerë, në çmime, siç ka ndodhur në të gjithë botën, por problemi është se kostoja ka të bëjë me tregun, nuk ka të bëjë me ligjin, pra tregu e komandon prodhimin dhe çmimin.

Ndërsa, për mendime të ndryshme, ne jemi totalisht të hapur t’i dëgjojmë, të ulemi përsëri, t’i diskutojmë, sepse nuk kemi nxitim për këtë punë. Unë kaq kisha, specialistët mund të japin përgjigjet e tyre.

**Eduard Shalsi** – Po, kolegët deputetë dhe relatorja bënë disa pyetje në lidhje me regjistrin.

**Alban Mësonjësi** – Për sa i takon kadastrës dhe regjistrin, në ligjin e ri është termi “regjistër”, por kjo kadastrë që është përgatitur do të jetë regjistër, pra është i njëjti nocioni, por tani është sipas legjislacionit.

Pyetja për konsultimin publik, u sqarua.

Për sa u përket shpenzimeve, shpenzimet në buxhetin e shtetit janë shuma të ulëta në lidhje me komisionin, pra janë brenda tavaneve buxhetore të miratuara për ministrinë dhe nuk ka ndonjë shpenzim të madh, janë shpenzime vjetore.

Për sa i përket pyetjes për masat administrative, në fund të fundit, vera ngelet ushqim dhe duhet të garantojmë sigurinë ushqimore, duke kontrolluar prodhimin dhe tregtimin e verës. Masat nuk janë të larta, por janë normale për të garantuar sigurinë ushqimore. Pra, kemi gjykuar që duhet të jenë këto masa, të cilat nuk penalizojnë bizneset, por, nga ana tjetër, janë të tilla që ne duhet të implementojmë politikat e sigurisë ushqimore. Prandaj i kemi gjykuar në këtë aspekt.

Për sa u përket politikave fiskale në sektor, ne jemi të ndjeshëm, por ky projektligj nuk është i karakterit që lehtëson apo vendos taksa. Prandaj me këtë projektligji ne nuk mund të komentojmë për këto gjëra.

**Eduard Shalsi** – Po, zoti Shehi.

**Dashamir Shehi** – Ne teknikisht nuk është se kemi ndonjë ekspertizë për çështjet e verës, prandaj duam që të kishim një kuadër pak më të përgjithshëm se çfarë përfaqëson vreshtaria te GDP-ja e bujqësisë, çfarë roli ka, çfarë politike kemi ndjekur, sepse ne ia kemi vendosur i titullin “mbi vreshtarinë”.

Ne kemi pasur subvencione disa vite për vreshtarinë, nëse nuk gaboj, i kemi hequr, do t'i mbajmë, do t'i rifusim; përse i hoqëm; cili është trendi, a është zgjeruar sipërfaqja e vreshtarisë në këto vite; roli i subvencioneve në këtë fushë do ta privilegjojë si sektor me të tjerët, pra janë disa pyetje që janë makro, të cilat na interesojnë ne për ekonominë.

Ekonomia e verës çfarë përfaqëson në eksportin tonë, jo në eksport për konsum të brendshëm, pra janë disa grafikë që ne na interesojnë, pastaj cilësia nga kultivarët e jugut apo të veriut janë specifika që i keni ju dhe ne nuk na duhen. Pra, duam të dimë diçka ekonomikisht se çfarë përfaqëson vreshtaria dhe bujqësia. Përse kishim subvencione apo si e keni menduar politikën brenda kësaj fushe, se këtë duhet të dimë. A ia vlen ta subvencionojmë këtë sektor, ta shtyjmë përpara, ta shkëpusim nga të tjerët, ta privilegjojmë brenda këtij sektori nënproduktet si verërat e të tjera, ku jemi me rajonin me Maqedoninë fqinje, nga e cila blejmë rrush dhe verë vazhdimisht, pra janë ca gjëra që do të na bënin më të mençur dhe më kompetentë në këtë sektor, pjesa tjetër është punë teknike, siç tha zonja, është *acquis communautaire*, të cilën do ta bëjmë siç e bën bota dhe po ta bëjmë shpejt do të jetë edhe më mirë akoma.

Të paktën të krijojmë një ide për të çfarë po flasim këtu. I gjithë ky muhabet që po bëjmë sa kushton në Shqipëri, 46 milionë, 22 milionë; çfarë përfaqësonë për ekonominë shqiptare, për ekonominë në përgjithësi, pra të bëhet një lloj analize qoftë edhe e përgjithshme që të krijojmë një ide për rëndësinë e sektorit.

**Eduard Shalsi** – Zoti Tarelli, çështja që ngriti zoti Shehi mund të përmbledhet në një informacion se çfarë ka ndodhur në vite; a kanë funksionuar apo jo subvencionet; për çfarë periudhe kohore janë zbatuar; përse u hoq dorë, cila është pjesa në produktin e përgjithshëm bruto; punësimi, pra një informacion për të kuptuar peshën specifike që luan rol në ekonomi dhe në bujqësi. Të lutem, sa më shpejt të jetë informacioni.

Ne sot do ta diskutojmë dhe do ta miratojmë në parim ligjin, ndërsa diskutimin nën për nen do ta bëjmë një moment tjetër.

**Irfan Tarelli** – Si ta gjykoni ju, por unë mund të them shkurtimisht disa tregues dhe pastaj ta plotësojmë me informacion të shkruar në vlerësimin tuaj.

**Eduard Shalsi** – Po, vazhdoni.

**Irfan Tarelli** – Faleminderit!

Atëherë, vreshtaria është një nga nënsektorët e rëndësishëm në peshën e prodhimit bujqësor. Aktualisht ne kemi rreth 12 mijë hektarë të mbjellë. E krahasuar me 6-7 vjetët e fundit kemi një rritje të sipërfaqeve me rreth 2 mijë hektarë.

Në terma prodhimi, ne prodhojmë rreth 200 mijë tonë rrush, përfshirë rrushin për verë dhe për tavolinë. Pra krahasuar me strukturat e tjera të prodhimeve futet te komponentët e rëndësishëm. Kemi afërsisht mbi 60 kantina, ndërsa numri i punishteve të vogla, përfshirë kantinat e mëdha, shkon mbi 300.

Zëvendësministri e tha se aktualisht ne prodhojmë rreth 26 mijë hektolitra. Kemi një regjim jo të favorshëm mes importit dhe eksportit, në dispropocion me potencialet që ne kemi. Pra, ne kemi potencial eksportin vetëm nëse përmirësojmë cilësinë e prodhimit të verave. Me investimet që janë bërë në kantina, me skemat kombëtare dhe me IPARD-in, kapacitetet përpunuese janë rritur ndjeshëm, sidomos vitet e fundit.

Edhe në IPARD III komponenti i mbështetjes së vreshtarisë, jo vetëm në përpunim, por edhe në strukturat e prodhimit, është një nga komponentët thelbësore te masa 1 e programit IPARD, financimi i të cili është gati dyfish me IPARD II. Pra, në kuptimin e mbështetjes financiare ne kemi instrumentet e duhura.

Efekt pozitiv, sidomos në rritjen e sipërfaqes, kanë dhënë subvencionet që nga viti 2013 deri në vitin 2020 për mbjellje vreshti, por edhe në përmirësim të teknologjisë.

Nëse flasim nga potenciali dhe po ta shikojmë në aspektin agronomik, Shqipëria futet në vendet me kushte jashtëzakonisht të favorshme. Një avantazh që kemi në raport me kulturat e tjera është se ne kemi kultivues autoktonë, të cilët mund të prodhojnë brendin shqiptar të verës jo vetëm për turizëm, por edhe për eksport.

Problemi këtu qëndron i lidhur me ligjin, pra ligji këtu synon të normojë sipas kriterëve dhe standardeve të Bashkimit European, të rregullojë sektorin, që vlen jo vetëm për prodhimin vendas, por edhe për marrëdhëniet e eksportit, sidomos për verën.

Informacion tjetër më të detajuar mund ta plotësojmë ditët e ardhshme.

Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është një llogaritje që duhet ta bëj, por në terma prodhimi jemi rreth 200 mijë tonë afërsisht në vit.

**Eduard Shalsi** – Të lutem, informacionin që ke mund t'ua vendosim në dispozicion deputetëve që sot edhe elektronikisht, edhe të printuar, ndërkohë që ne do të rishihemi për diskutimin nen për nen.

Hedhim në votim në parim projektligjin.

Kush është dakord me projektligjin në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Faleminderit të nderuar kolegë deputetë.

Dua të bëj një njoftim, Presidenti i Republikës së Shqipërisë ka dekretuar zotin Gent Sejko Guvernator të Bankës së Shqipërisë dhe në fillim të javës tjetër, në bazë të procedurave parlamentare, duhet të bëjmë një seancë dëgjimore me Guvernatorin në detyrë dhe kandidatin për Guvernator të Bankës së Shqipërisë. Për datën do t'ju njoftoj ndoshta nesër.

Duke falënderuar edhe përfaqësuesit e ministrisë, rishihemi nesër në seancë plenare!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

**Sekretare e komisionit**

**Enslemvera Zake**

**Përgjegjësja e Shërbimit të Redaktorëve**

**Euzheni Pengili**

**Sekretar Administrativ**

**Elvi Prifti**